



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1282/3 Prot

Tiranë, më 2.8.2023

VENDIM

Nr. 35, datë 2.8.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1282 Prot., datë 24.07.2023 (saktësuar me nr. 1282/1 Prot., datë 28.07.2023), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 06.07.2023, me pretendimin se, sipas raportit të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit i publikuar në korrik 2022, për periudhën nga data 01.09.2018 deri më datë 31.12.2021 ndaj Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, zbulohet se mungonin raportet e monitorimit në vite të ndryshme për kompaninë “Bankers Petroleum Albania” dhe konkretisht mungonin dokumentacionet për shpenzimet e kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga Bankers Petroleum Albania për vitin 2014, 2015, 2016, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si vijon:

1. A janë dorëzuar këto dokumente nga kompania “Bankers Petroleum Albania” tek Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore?

- a) Nëse janë dorëzuar, cilat janë efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera sipas dokumentave për vitet që mungojnë në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit?
- b) A janë dorëzuar dokumentet për vitin 2022 nga kompania “Bankers Petroleum Albania” tek AKBN-ja? Nëse janë dorëzuar, cilat janë efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera për vitin 2022?
2. Sa është vlera e koeficientit “R” për totalin e 4 raporteve 3-mujore të hartuara për vitin 2022 nga kompania “Bankers Petroleum Albania” të dorëzuara tek AKBN-ja?
3. Kopje të raportit të auditimit për vitin 2019 të realizuar tek kompania “Bankers Petroleum Albania” nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
 - a) Kopje të raportit të auditimit për vitin 2020 të realizuar tek kompania “Bankers Petroleum Albania” nga AKBN-ja.
 - b) Kopje të raportit të auditimit për vitin 2021 të realizuar tek kompania “Bankers Petroleum Albania” nga AKBN-ja.
 - c) Kopje të raportit të auditimit për vitin 2022 të realizuar tek kompania “Bankers Petroleum Albania” nga AKBN-ja.
4. A është dorëzuar Programi Vjetor dhe Buxheti që paraqet Operacionet Hidrokarbure që do të kryhen gjatë Vitit Fiskal nga “Bankers Petroleum Albania” për vitin 2022? Ju lutem, na vendosni në dispozicion kopje të Programit Vjetor dhe Buxhetit sipas parashikimeve të përfshira.
5. A është dorëzuar Programi Vjetor dhe Buxheti që paraqet Operacionet Hidrokarbure që do të kryhen gjatë Vitit Fiskal nga Bankers Petroleum për vitin 2023? Ju lutem, na vendosni në dispozicion kopje të Programit Vjetor dhe Buxhetit sipas parashikimeve të përfshira.
6. A janë kryer raporte për efektet në mjedis nga veprimtaria e kompanisë “Bankers Petroleum Albania” në zonat e pasur me hidrokarbure në qarkun e Fierit? A ka konstatuar AKBN-ja dëme në mjedis? Nëse ka konstatuar dëme, cilat kanë qenë masat e marra ndaj subjektit?

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 19.07.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “... Pikë së pari lidhur me sa citohet në kërkesën për informacion “...ndaj Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (në vijim, “AKBN”), zbulohet se mungonin raportet e monitorimit në vite të ndryshme për kompaninë “Bankers Petroleum Albania...” sjellim në vëmendjen tuaj se AKBN ka kryer çdo monitorim të mundshëm ndaj Kompanisë BPAL duke respektuar çdo parashikim kontraktual. Nëse do t’i referohemi saktë raportit të auditit të KLSH, citohet se AKBN duhet t’i kërkojë Kompanisë BPAL të dorëzojë pranë AKBN-së dokumentacionin lidhur me kostot e realizuara për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Rekomandim i cili është realizuar prej AKBN-së dhe jemi në pritje të plotësisimit të dokumentacionit nga ana e Kompanisë BPAL.

Lidhur me pikën 1.a, sqarojmë se në përputhje me parashikimet e Licencë Marrëveshjes AKBN ka kryer auditimin për periudhat 2014-2019, për të cilat ka konkluduar dhe

raportet paraprake të auditimit. Aktualisht AKBN është në proces auditimi për vitin 2020-2021, proces i cili po kryhet pranë zyrave të shoqërisë.

Lidhur me pikën 1.b, sqarojmë se për vitin 2022 shoqëria BPAL ka dërguar pranë AKBN raportimet tremujore, të cilat do të auditohen brenda afateve që percakton LM për audit. Në përputhje me Nenin 23 të MH “Konfidencialiteti” “...i gjithë informacioni i kryer apo përfutur ose marrë sipas kësaj marrëveshje do të mbahet nga Palët konfidencial në mënyrë strikte....”. Duke qenë se këto raporte janë dokumentacion i cili është përfutur prej parashikimeve kontraktuale, AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto dokumentacione.

Lidhur me pikën 2, ashtu sikurse kemi cituar më sipër, të dhenat e kërkuara prej jush siç është “vlera e koeficientit “R” për totalin e 4 raporteve 3-mujore të hartuara për vitin 2022”, sqarojmë se AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto të dhëna për sa kohë kjo është një tregues i përfutur nga MH për vendburimin Patos - Marinëz.

Lidhur me pikën 3, sqarojmë faktin se AKBN është në proces auditimi pranë kësaj kompanie për vitet 2020, 2021 dhe 2022. Sqarojmë se e drejta e AKBN për të audituar këto kompani, e parashikuar në nenet specifike të kryerjes së auditimit, përfundon 3 (tre) vite pasi ka mbaruar viti fiskal. Gjithashtu, pavarësisht këtij fakti, duke ju referuar parashikimeve kontraktuale të cituar dhe më sipër, AKBN është e detyruar të reprojektojë nenin përkatës të Marrëveshjes Hidrokarbure lidhur me konfidencialitetin.

Lidhur me pikat 4 dhe 5, së pari sqarojmë faktin se Palë në Marrëveshjen Hidrokarbure janë Kompania Albpetrol sh.a., dhe Kompania Bankers Petroleum Albania Ltd. Kompania Albpetrol në rolin e partnerit në këtë MH, ndjek nga afër çdo operacion hidrokarbur të realizuar nga Kontraktori BPAL. Ashtu sikurse edhe për dokumentacionet e kërkuara nga ana juaj lidhur me Programet Vjetore dhe Buxhetet për vitet 2022-2023, Ju bëjmë me dije se këto programe përpara dërgimit pranë AKBN-së do duhet të diskutohen dhe miratohen ndërmjet Palëve të MH. Gjithashtu, sqarojmë se në zbatim të Nenit 23 të Marrëveshjes Hidrokarbure lidhur midis Albpetrol sh.a., dhe Bankers Petroleum Albania Ltd., “...i gjithë informacioni i kryer apo përfutur ose marrë sipas kësaj marrëveshje do të mbahet nga Palët konfidencial në mënyrë strikte...”. Në të tilla kushte, AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto dokumentacione.

Lidhur me pikën 6, sqarojmë faktin se AKBN është një institucion teknik, i cili në sektorin hidrokarbur është i fokusuar në ndjekjen e operacioneve hidrokarbure që kryejnë kompanitë të cilat disponojnë një Marrëveshje Hidrokarbure. AKBN, ka kryer monitorime periodike çdo vit, në të gjitha vendburimet apo blloqet të cilat janë nënkontraktuar me investitorë vendas apo të huaj të cilët kryejnë operacione hidrokarbure. Lidhur me monitorimet mjedisore, ashtu sikurse ju e dini, ka institucione të specializuara dhe të caktuara me ligj që kryejnë këto procedura me qëllim konstatimin nëse janë shkaktuar dëme mjedisore dhe në çdo rast aplikimin e sanksioneve përkatëse sipas parashikimeve ligjore. ”

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se: “...Autoriteti Publik nuk ka dhënë informacionin e kërkuar nën arsyetimin se është pjesë konfidenciale e kontratës. Por, arsyetimi i Autoritetit Publik nuk qëndron sepse këto janë të dhëna që lidhen me pasuritë publike.

Përpos kësaj ne kemi si precedent të mëparshëm rastin e Qendrës “Res Publica” me

Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për informacion për kontratën e “Bankers Petroleum Albania” me Ministrinë në 2017, ku Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vendosur në favor të Qendrës “Res Publica” për të vendosur në dispozicion këtë kontratë.”

Në këto kushte, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit për pikat 1 “b” dhe 2 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim, “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 31.07.2023, me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit përkatës, sipas pikave 1 “b” dhe 2 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023.

Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në *-mail-*in datë 19.07.2023, duke mos pranuar të rivlerësojnë qëndrimin e mbajtur në përputhje me LDI.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, argumentave të palëve dhe dokumentacionit dhe të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Konkretisht, Komisioneri vlerëson se argumenti i Autoritetit Publik se: *“Lidhur me pikën 1.b, ...Në përputhje me Nenin 23 të MH “Konfidencialiteti” “....i gjithë informacioni i kryer apo përfituar ose marrë sipas kësaj marrëveshje do të mbahet nga Palët konfidencial në mënyrë strikte....”. Duke qenë se këto raporte janë dokumentacion i cili është përfituar prej parashikimeve kontraktuale, AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto dokumentacione.*

Lidhur me pikën 2, ashtu sikurse kemi cituar më sipër, të dhënat e kërkuara, siç është “vlera e koeficientit “R” për totalin e 4 raporteve 3-mujore të hartuara për vitin 2022”, AKBN nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj këto të dhëna për sa kohë kjo është një tregues i përfituar nga MH për vendburimin Patos - Marinëz, nuk qëndron.

Autoriteti Publik, citon si pengesë ligjore nenin 23 të Marrëveshjes Hidrokarbure të datës 19 qershor 2004, miratuar me Vendimin nr. 477, datë 16.07.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos – Marinës”, të ndryshuar, lidhur nëpërmjet Albpetrol SH.A-së dhe Bankers Petroleum Albania, Ltd, që lidhet me konfidencialitetin, por nuk ka argumentuar saktësisht se si dhënia e këtij informacioni mund të çënojë apo shkelë këto parime.

Nga verifikimi i legjisllacionit të posaçëm që rregullon marrëveshjen e hidrokarbure nuk rezulton që informacioni objekt shqyrtimi, të parashikohet si informacion konfidencial, për të autorizuar në këtë mënyrë lidhjen e një marrëveshje të tillë dhe legjitimitimin e Autoritetit Publik për kufizimin e të drejtës për informim të qytetarëve.

Në nenin 3 të ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar”.*

Për më tepër, në pikën 3 të nenit 9, të këtij ligji parashikohet, gjithashtu se: *“3. Në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure, organet e administratës tatimore dhe doganore, si dhe organet e qeverisjes qendrore dhe vendore kanë detyrimin të raportojnë, sipas standardit të caktuar nga kjo Nismë, pranë 7 Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.*

Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse publikon të dhënat sipas standardit EITI.”

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse mbështet qëndrimin se burimet natyrore të një vendi u përkasin qytetarëve të tij. Rregullat e parashikuara në Standartin EITI, nënkuptojnë vendosjen e transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit. Po ashtu, EITI ka për qëllim promovimin e transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t'i sigurojë qytetarëve një bazë për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave.

Për këtë arsye, vendet anëtare të EITI angazhohen ndër të tjera të rrisin sasisë e informacionit për publikun përgjatë të gjithë procesit të industrisë nxjerrëse, duke kontribuar kështu në forcimin e qeverisjes dhe llogaridhënies publike, si dhe krijimin e mekanizmave për mirëadministrim e të ardhurave nga ky sektor, në dobi të qytetarëve.

Në këto kushte, duke qenë se sipas ligjit të sipërcituar, hidrokarburet konsiderohen pronë ekskluzive e shtetit shqiptar dhe si të tilla janë pasuri publike, mosbërja publike në tërësi e informacionit me interes publik, me pretendimin e ruajtjes së konfidencialitetit, nuk gjen bazë ligjore dhe shkon kundër frymës së legjislacionit të mësipërm.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështetet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim. Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese të përcaktuar në këtë marrëveshje, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në kërkesën për informacion datë 06.07.2023, konkretisht kërkesa që lidhet me 1 “b” dhe 2, përmbush në parim kriteret e pikës 2, të nenit 2, të LDI, në të cilën parashikohet se: *“informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar, sipas të cilës: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti

tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Kërkuesi/ankuesi, është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1282 Prot., datë 24.07.2023 (saktësuar me nr. 1282/1 Prot., datë 28.07.2023) nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës sipas pikave 1 “b” dhe 2 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, konkretisht: *“1. b) A janë dorëzuar dokumentet për vitin 2022 nga kompania “Bankers Petroleum Albania” tek AKBN-ja? Nëse janë dorëzuar, cilat janë efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera për vitin 2022? 2. Sa është vlera e koeficientit “R” për totalin e 4 raporteve 3-mujore të hartuara për vitin 2022 nga kompania*

“Bankers Petroleum Albania” të dorëzuara tek AKBN-ja?”, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 09.8.2023.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02.8.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi